



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 114

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 4 korrik 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 26.6.2024	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Elbasanit..... 13795
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 3190/16, datë 14.6.2024	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare..... 13795
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 2819, datë 27.6.2024	Për refuzimin e ankimit administrativ të subjektit “Micro Credit Albania” sh.p.k. 13795
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 2820, datë 27.6.2024	Për refuzimin e ankimit administrativ të subjektit “Final” sh.p.k..... 13798
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 100, datë 27.5.2024	Mbi miratimin e “Metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni i energjisë elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës”... 13800
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 101, datë 27.5.2024	Mbi miratimin e “Procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri–Kosovë”..... 13809
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 107, datë 31.5.2024	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 175, datë 4.11.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Tirana Energji’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Mali’, me kapacitet të instaluar 1490 kw” 13816
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 8762, datë 4.3.2024	Me objekt kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë tregtare “Besa Agro Invest” sh.p.k., me kërkesë të debitorit. Caktimin e administratorit të falimentimit. Vendosijen e masës së sigurimit mbi të gjitha pasuritë e luajtshme, të paluajtshme, si dhe të drejtat e debitorit..... 13817
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 289 (1861), datë 16.4.2024	Për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar të shtetases Sose Gilaj..... 13819

Vendim i Gjykatës së Shkallës së
Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm
Shkodër nr. 152 (970),
datë 27.2.2024

Për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Gjon Kuqaj... 13819



VENDIM
Nr. 432, datë 26.6.2024

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ali Mysliu emërohet prefekt i qarkut të Elbasanit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

NJOFTIM
Nr. 3190/16, datë 14.6.2024

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË
MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE

Protokolli i parë për zbatimin e marrëveshjes mbi kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor, nënshkruar në Shkup, më 22.1.2024, ka hyrë në fuqi më 14 qershor 2024.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT
E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM
Nr. 2819, datë 27.6.2024

Sot më datë 27.6.2024, pasi shqyrtova ankimin administrativ të subjektit “Micro Credit Albania” sh.p.k., me anë të të cilit kërkohet shfuqizimi i vendimit nr. 2302, datë 23.5.2024, “Për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë ‘Micro Credit Albania’ sh.p.k.”, dhe analizova historikun e licencimit dhe të ecurisë së procesit të mbikëqyrjes

së subjektit financiar jobankë “Micro Credit Albania” sh.p.k.,

VËREJ:

I. Rrethanat e procedimit administrativ:

Subjekti financiar jobankë “Micro Credit Albania” sh.p.k. (MCA), është licencuar për kryerjen e veprimtarive financiare, “të gjitha format e kredidhënies” dhe “shërbimeve këshilluese ndërmjetëse” dhe “shërbime të tjera ndihmëse për veprimtarinë e kredidhënies” sipas licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë nr. 38, datë 9.5.2016.

Me vendimin nr. 5689, datë 19.12.2022, të Guvernatorit, veprimtaria e subjektit financiar jobankë “Micro Credit Albania” sh.p.k. u pezullua deri më 31.12.2023, për një periudhë 12-mujore.

Me vendimin nr. 644, datë 6.2.2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, për shkelje të përsëritura dhe të paadresuara nga ana e subjektit, vendosi të caktojë masën e pezullimit me kufizime të tjera shtesë të veprimtarive të përcaktuara në licencë për këtë subjekt deri më datë 30.6.2024.

Me shkresën nr. 12287/1, datë 23.5.2024, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Banka e Shqipërisë u vu në dijeni të faktit se ndaj ortakut Elda Ibro, të subjektit financiar jobankë “Micro Credit Albania” sh.p.k., është vendosur masa e sigurimit personal “arrest shtëpi” nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në nenin 10, pika 1, shkronja “a”, e rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.1.2013, i ndryshuar, parashikohet se një ndër kriteret që duhet të plotësojnë në vazhdimësi subjektet financiare jobanka gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre është që themeluesit/e subjektit të kenë reputacion të mirë.

Për rrjedhojë, pas informacionit të marrë nga Prokuroria, në zbatim të nenit 14, pika 1, shkronja “h”, të rregullores së mësipërme, si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, me vendimin nr. 2302, datë 23.5.2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë vendosi revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë “Micro Credit Albania” sh.p.k.



II. Pretendimet e paraqitura në ankimin administrativ:

Ndaj vendimit të mësipërm nr. 2302, datë 23.5.2024, për revokimin e licencës, ka paraqitur ankim subjekti “Micro Credit Albania” sh.p.k., ku ka parashtruar se:

1. Banka e Shqipërisë nuk ka respektuar kushtet dhe kërkesat procedurat e parashikuara nga kuadri ligjor në lidhje me vendimmarrjen përkatëse, e cila në çdo rast ka qenë disproporcionale.

2. Ortakja e shoqërisë znj. Elda Ibro, nuk ka kompetenca administrative pranë shoqërisë MCA sh.p.k. dhe pengesa, ndalimi ligjor, efektet negative janë lehtësisht të evitueshme (pa pasur ndikim negativ në shoqëri, me kalimin e kuotës që zotëron ajo në shoqërinë MCA sh.p.k.).

3. Prej fillimit të aktivitetit të shoqërisë MCA sh.p.k., duke bërë dallimin e pozitës procedurale të personit nën hetim, pasi çdo shtetas përfshirë dhe Presidentin e Republikës mund të jetë shtetas nën hetim sipas K.Pr.Penale, deri ditën e sotme asnjë punonjës, apo ortak i MCA sh.p.k., nuk i është komunikuar asnjë akuzë zyrtare që mund të ketë lidhje ose jo me aktivitetin e shoqërisë.

4. Prej fillimit të aktivitetit të shoqërisë MCA sh.p.k., duke bërë dallimin e legjislacionit civil me legjislacionin penal deri ditën e sotme nuk rezulton asnjë vendimarrje gjyqësore që të ngarkojë MCA sh.p.k. me detyrimin e kthimit të shumave monetare, të cilat janë sekuestruar në mënyrë të paligjshme, të parregullt, më shumë se sa parashikohet nga detyrimet kontraktuale, apo vendimet gjyqësore përkatëse.

Për sa më sipër, kërkohet shfuqizimi i vendimit 2302, datë 23.5.2024, “Për revokimin e licencës së subjektit financiar jobank ‘Micro Credit Albania’ sh.p.k.”.

III. Arsyetimi ligjor

1) Në lidhje me pretendimin e subjektit për mosrespektim të kërkesave procedurale në nxjerrjen e aktit administrativ.

Banka e Shqipërisë, me marrjen e njoftimit nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është vënë në dijeni të faktit se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë kishte miratuar kërkesën e Prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit personal për ortakun e vetëm të subjektit “Micro Credit Albania” sh.p.k. Ky fakt, i cili në aktet rregullative sa i përket licencimit dhe, rrjedhimisht, mbajtjes së licencës gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga subjekti, përbën një mbështetje të pakundërshtueshme që justifikon plotësisht vendimmarrjen e Bankës së Shqipërisë.

Kjo vendimarrje i është komunikuar subjektit nga Banka e Shqipërisë edhe pse në tentativat për të komunikuar me administratorin e subjektit është përballuar me “heshtje”. Subjekti ka qenë i ngarkuar nga Banka e Shqipërisë pas marrjes së vendimit nr. 644, datë 6.2.2024 të komunikonte rregullisht në lidhje me vijimin e përmbushjes së detyrimeve më të cilat u ngarkua nga ky vendim. Përpjekjeve të Bankës së Shqipërisë për të marrë informacion, administratori i subjektit nuk i është përgjigjur personalisht. Më tej, edhe dërgimi i vendimit për revokimin e licencës është kthyer mbrapsht 2 herë nga shërbimi postar, pasi subjekti nuk gjendej në adresat e deklaruara. Dorëzimi është bërë me korrier privat, dhe në këtë rast vetëm pas komunikimit me një punonjëse të “Micro Credit Albania” sh.p.k. Fakti që Banka e Shqipërisë po shqyrton ankimin ndaj asaj vendimarrje, konfirmon vullnetin e këtij institucioni për të respektuar gjithë detyrimet sa i përket procedimit administrativ.

2) Në lidhje me pretendimin që masa e sigurimit personal ndaj ortakut të shoqërisë, nuk cenon vijueshmërinë e aktivitetit të subjektit arsyetohet se reputacioni i shoqërisë për shkak të masës ndaluese të marrë ndaj ortakut është i cenuar rëndë. Tjetërsimi i kuotës që zotëron ortakut i ndaluar me masë sigurimi nuk nënkupton që reputacioni i këtij subjekti është i pacenueshëm sipas përcaktimeve rregullatore. Po ashtu, për aq kohë sa subjekti ka kohë që nuk përmbush asnjë nga detyrimet e ngarkuara nga Banka e Shqipërisë, krijoi bindjen se organet e shoqërisë nuk janë funksionale. Nga ana tjetër, fakti që komunikimi me administratorin e subjektit nuk ka funksionuar, kjo për faj të administratorit, më bind se pretendimi juaj për vijueshmërinë e veprimtarisë së shoqërisë nga administratori i saj është i pambështetur.

3) Në lidhje me pretendimin tuaj se nuk ka ende një akuzë të komunikuar nga organi i hetimit, konfirmoj se vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë është mbështetur tërësisht në kuadrin rregullativ në fuqi. Konkretisht, rregullorja “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka” miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.1.2013, i ndryshuar, parashikon kriteret dhe kushtet që duhet të përmbushin subjektet financiare jobanka, të cilat kërkojnë të licencohen nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarive financiare. Këto kriteret, janë të zbatueshme për t’u përmbushur jo vetëm në momentin e licencimit, por duhet që



këto kritere të përmbushen në vijimësi gjatë gjithë veprimtarisë financiare të subjektit financiar jobankë.

Një ndër kriteret e rëndësishme për dhënien apo refuzimin e licencës është i parashikuar në nenin 10 të rregullores së licencimit dhe që lidhet me reputacionin e themeluesit (ortaku i vetëm) të shoqërisë. Më konkretisht, pika 1, e këtij neni përcakton:

“Banka e Shqipërisë merr vendim për dhënien e licencës vetëm kur krijon bindjen se subjekti plotëson kërkesat e kësaj rregulloreje, për sa u përket kushteve të mëposhtme:

a) themeluesit e subjektit të kenë reputacion të mirë, burim të ligjshëm të kontributeve në kapital, veprimtari të ligjshme, të regjistruar dhe që mund të mbikëqyrret, të kenë mundësi financiare për derdhjen e fondeve shtesë në qoftë se kapitali bie nën nivelin minimal të kërkuar nga Banka e Shqipërisë ose për realizimin e financimeve të nevojshme për vazhdimin e qëndrueshëm në kohë të veprimtarisë së subjektit;

b) kualifikimet, përvoja e reputacioni i administratorit dhe i themeluesve me pjesëmarrje influencuese të jenë të përshtatshme për realizimin e planit të biznesit.”

Ndërkohë, që pika 2 (nënpika 4), e po këtij neni të rregullores, bën një parashikim akoma më eksplisit, duke u shprehur:

“Banka e Shqipërisë refuzon dhënien e licencës kur nuk plotësohen kërkesat e kësaj rregulloreje, në rastet e mëposhtme:

4. vërtetohet se të paktën njëri nga themeluesit:

i. është në ndjekje penale ose është dënua nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore;

ii. është në ndjekje penale ose është dënua nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që lidhet me pastrimin e parave ose me financimin e terrorizmit, dhe

Pra, reputacioni i themeluesit të shoqërisë është një ndër kriteret kryesore që duhet të përmbushi një subjekt financiar jobankë, për këtë arsye, pjesë e dokumentacionit të licencimit në nenin 8, pika 2, shkronja “f”, të rregullores së licencimit, parashikohet **paraqitja e vërtetimit për theme-luesit se personi nuk është në ndjekje penale.**

Ky kriter është i rëndësishëm të përmbushet jo vetëm në periudhën e licencimit, por edhe gjatë gjithë veprimtarisë së subjektit, pasi vetë rregullorja në nenin 14 të saj parashikon se subjektit financiar i pezullohet apo i revokohet licenca, nëse nuk

përmbush kushtet bazë për të cilat është licencuar dhe siç e përmendëm edhe më sipër, një ndër kushtet kryesore është reputacioni i themeluesit/drejtuesve të shoqërisë (ortaku i vetëm) të shoqërisë. Nëse ky reputacion cenohet, atëherë subjekti nuk mund të ushtrojë veprimtarinë financiare për të cilën është licencuar, pasi bie një ndër kriteret kryesore të licencimit, që ka të bëjë me reputacionin e tij për të ushtruar veprimtaritë për të cilat është i licencuar.

Vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë për revokimin e licencës ndaj subjektit MCA, gjen mbështetje edhe nga ecuria e veprimeve procedurale të ndërmarra nga organi i akuzës.

Me shkresën nr. 12828 prot., datë 29.5.2024, jemi informuar nga Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm të Rrethit Gjyqësor Tiranë, për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale” për vepra penale të dyshuara gjatë ushtrimit të aktivitetit financiar edhe të shoqërisë “Micro Credit Albania” sh.p.k. dhe ka urdhëruar sekuestrimin e llogarive bankare të kësaj shoqërie dhe të Elda Ibro dhe personat e lidhur me ta.

4) Në lidhje me pretendimet në ankim *se masa e revokimit është disproporcionale*, pasi u informova edhe njëherë me hollësi rreth gjithë procesit të mbikëqyrjes të subjektit “Micro Credit Albania” sh.p.k., shkallën e shkeljeve të konstatuara në disa vite, mosreagimin e subjektit për të korrigjuar mangësitë e vërejtura, vlerësova edhe njëherë mbështetjen jo në fakte të provuara të pretendimit të subjektit për vendimmarrje joproporcionale të Bankës së Shqipërisë, dhe analizoj se:

Siç është përmendur edhe më sipër me vendimin nr. 5689, datë 19.12.2022, të Guvernatorit, veprimtaria e subjektit financiar jobankë “Micro Credit Albania” sh.p.k. ka qenë e pezulluar deri më 31.12.2023, për një periudhë 12-mujore. Gjatë kësaj periudhe subjekti u urdhërua të merrte masa për adresimin e plotë të të gjitha mangësive dhe rekomandimeve të evidentuara në raportin e ekzaminimit nr. 761/3 prot., datë 25.11.2020 dhe në raportin e ekzaminimit nr. 6343/1 prot., datë 5.12.2022. Bankës së Shqipërisë i rezultoi se asnjë nga detyrat e lëna nuk u adresuan nga subjekti “Micro Credit Albania” sh.p.k.

Me vendimin nr. 644, datë 6.2.2024, të Guvernatorit, për shkelje të përsëritura dhe të paadresuara nga ana e subjektit, në mënyrë të



përshkallëzuar Banka e Shqipërisë vendosi të kufizojë ushtrimin e të gjitha veprimtarive për të cilën subjekti ishte licencuar, përveç shitjes së portofolit të kredive që ky subjekt administron. Kjo masë pezullimi e licencës i shtrinte efektet deri më datë 30.6.2024. Kjo në vijim të strategjisë të ushtrimit të veprimtarisë nga subjekti “Micro Credit Albania” sh.p.k., pasqyruar në vendimarrjen e ortakut të vetëm të shoqërisë të datës 5.1.2024, sipas të cilit shoqëria do ta shiste të gjithë portofolin e kredisë që administron.

Të dyja vendimet e mësipërme për pezullimin e veprimtarisë, nuk janë ankimuar në gjykatë nga subjekti “Micro Credit Albania” sh.p.k. duke pranuar në këtë mënyrë se vendimarrja e Bankës së Shqipërisë ka qenë e drejtë dhe në përputhje me natyrën dhe shkallën e shkeljeve të konstatuara. Siç edhe ka rezultuar, subjekti nuk mori asnjëherë masa për eliminimin e shkeljeve. Jo vetëm kaq, por ka rezultuar se subjekti nuk rezulton të ketë dhe nuk ka pasur të angazhuar strukturat e nevojshme për eliminimin e këtyre shkeljeve, siç konfirmohet edhe nga konkluzionet e raportit të ekzaminimit të plotë, dorëzuar me shkresën nr. 799/3, datë 25.1.2024. Edhe në mesazhin elektronik të datës 20.4.2024, të punonjësës së MCA-së, nëpërmjet të cilit përcillet qëndrimi i ortakes së vetme të shoqërisë, znj. Elda Ibro, i kërkohet Bankës së Shqipërisë të lejojë dorëzimin e licencës nga MCA-ja, dhe lirin nga detyra të administratorit z. Andis Gjoka.

Strategjia e vijueshmërisë të aktivitetit të subjektit për shitjen e të gjitha kredive të 4 subjekte, siç është pohuar prej vetë subjektit ka rezultuar e papërmbushur. Në analizë të arsytimit të mësipërm, në balancë të vendimarrjes së Bankës së Shqipërisë ndaj sjelljes tërësore të subjektit “Micro Credit Albania” sh.p.k., konstatoj se vendimarrja e Bankës së Shqipërisë për revokimin e licencës ndaj këtij subjekti është e përshtatshme dhe gjendet plotësisht e mbështetur në aktet rregullative të cituara në këtë vendim.

Bazuar në sa më sipër, vlerësoj se pretendimet e paraqitura në ankimin administrativ nga “Micro Credit Albania” sh.p.k., nuk janë të bazuara dhe nuk përbëjnë shkak për të marrë një vendim të ndryshëm nga ai me nr. 2302, datë 23.5.2024.

PËR KËTO ARSYE,

Në mbështetje të nenit 93, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neneve 130–140, të Kodit të Procedurave Administrative,

VENDOSA:

1. Refuzimin e ankimit si të pabazuar dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 2302, datë 23.5.2024, për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë “Micro Credit Albania” sh.p.k.

2. Vendimi t’i njoftohet subjektit ankimues “Micro Credit Albania” sh.p.k.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatë sipas ligjit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare.

GUVERNATOR
Gent Sejko

VENDIM Nr. 2820, datë 27.6.2024

Sot më datë 27.6.2024, pasi shqyrtova ankimin administrativ të subjektit “Final” sh.p.k., me anë të së cilit kërkohet shfuqizimi i vendimit nr. 2303, datë 23.5.2024, “Për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë ‘Final’ sh.p.k.” dhe analizova historikun e licencimit dhe të ecurisë së procesit të mbikëqyrjes së subjektit financiar jobankë “Final” sh.p.k.,

VËREJ:

I. Rrethanat e procedimit administrativ:

Subjekti financiar jobankë “Final” sh.p.k. është licencuar për kryerjen e veprimtarive të qirasë financiare dhe të të gjitha formave të kredidhënies, sipas licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë nr. 11, datë 20.2.2009.

Me shkresën nr. 12287/1, datë 23.5.2024, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm të Rrethit Gjyqësor Tiranë, Banka e Shqipërisë u vu në dijeni të faktit se ndaj ortakut Arben Meskuti, të subjektit financiar jobankë “Final” sh.p.k., është vendosur masa e



sigurimit personal “arrest në burg” nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 10, pika 1, shkronja “a”, e rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.1.2013, të ndryshuar, parashikon se një ndër kriteret që duhet të plotësojnë në vazhdimësi subjektet financiare jobanka gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre është që themeluesit e subjektit të kenë reputacion të mirë.

Neni 10, pika 1, shkronja “a”, e rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.1.2013, të ndryshuar, parashikon se një ndër kriteret që duhet të plotësojnë në vazhdimësi subjektet financiare jobanka gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre është që themeluesit e subjektit të kenë reputacion të mirë.

Për rrjedhojë, në kushtet e informacionit të marrë nga Prokuroria, në zbatim të nenit 14, pika 1, shkronja “h”, të rregullores së mësipërme, si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, me vendimin nr. 2303, datë 23.5.2024, Guvernatori vendosi për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë “Final” sh.p.k.

II. Pretendimet e paraqitura në ankimin administrativ:

Ndaj vendimit nr. 2303, datë 23.5.2024, “Për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë ‘Final’ sh.p.k.”, ka bërë ankim subjekti “Final” sh.p.k., në të cilin ka parashtruar:

a. *Vendimi për të cilin paraqesim ankim është marrë pa asnjë shkak ligjor/nëligjor apo në keqinterpretim të dispozitave rregullatore;*

b. *Marrja e masës së sigurimit personal ndaj ortakut të vetëm të “Final” sh.p.k., Arben Meskuti:*

1. *nuk ka asnjë lidhje shkakësore, kobore, ligjore, funksionale me aktivitetin e “Final” sh.p.k. apo cilësinë e ortakut të vetëm të “Final” sh.p.k.;*

2. *nuk passjell ndikim negativ në aktivitetin e ardhshëm të “Final” sh.p.k. apo të jetë ndikuar nga aktiviteti i deritanishëm i “Final” sh.p.k.;*

3. *pa paragjykuar vendimarrjen e mëtejshme gjyqësore (duke prezumuar në çdo rast pajajësinë apo ndryshimin e masës së sigurimit) për z. Meskuti, në lidhje me masën e sigurimit personal, apo akuzën që ende nuk është komunikuar/ngritur, mund të ketë të njëjtin efekt negativ/pozitiv (reversë) edhe në vendimarrjen e mëtejshme të Bankës së Shqipërisë;*

c. procedura administrative e ndjekur dhe vendimarrja e Bankës së Shqipërisë (në vijim të kësaj procedure) konsiderojmë që nuk ka respektuar kuadrin rregullativ administrativ ligjor.

Në përfundim, kërkohet shfuqizimi i vendimit nr. 2303, datë 23.5.2024, “Për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë ‘Final’ sh.p.k.”.

III. Arsyetimi ligjor

Rregullorja “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.1.2013, të ndryshuar, parashikon kriteret dhe kushtet që duhet të përmbushin subjektet financiare jobanka, të cilat kërkojnë të licencohen nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarive financiare. Këto kritere janë të zbatueshme për t’u përmbushur jo vetëm në momentin e licencimit, por duhet që këto kritere të përmbushen në vijimësi, gjatë të gjithë veprimtarisë financiare të subjektit financiar jobankë.

Një ndër kriteret e rëndësishme për dhënien apo refuzimin e licencës është i parashikuar në nenin 10 të rregullores së licencimit dhe që lidhet me reputacionin e themeluesit (aksionarit) të shoqërisë. Më konkretisht, pika 1, e këtij neni përcakton:

“Banka e Shqipërisë merr vendim për dhënien e licencës vetëm kur krijon bindjen se subjekti plotëson kërkesat e kësaj rregulloreje, për sa i përket kushteve të mëposhtme:

a) *themeluesit e subjektit të kenë reputacion të mirë, burim të ligjshëm të kontributeve në kapital, veprimtari të ligjshme, të regjistruar dhe që mund të mbikëqyrret, të kenë mundësi financiare për derdhjen e fondeve shtesë në qoftë se kapitali bie nën nivelin minimal të kërkuar nga Banka e Shqipërisë ose për realizimin e financimeve të nevojshme për vazhdimin e qëndrueshëm në kohë të veprimtarisë së subjektit;*

b) *kualifikimet, përvoja e reputacioni i administratorit dhe i themeluesve me pjesëmarrje influencuese të jenë të përshtatshme për realizimin e planit të biznesit.”.*

Ndërkohë që pika 2 (nënpika 4), e po këtij neni të rregullores, bën një parashikim akoma më eksplicit, duke u shprehur:

“Banka e Shqipërisë refuzon dhënien e licencës kur nuk plotësohen kërkesat e kësaj rregulloreje, në rastet e mëposhtme:

4. *vërtetohet se të paktën njëri nga theme- luesit:*

i. *është në ndjekje penale ose është dënuar nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me rreziqshmëri të lartë shoqërore;*



ii. është në ndjekje penale ose është dënuar nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale që lidhet me pastrimin e parave ose me financimin e terrorizimit; dhe”.

Pra, reputacioni i themeluesve në vijim edhe i të gjithë anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë, është një ndër kriteret kryesore që duhet të përmbushë një subjekt financiar jobankë, për këtë arsye, pjesë e dokumentacionit të licencimit në nenin 8, pika 2, shkronja “P”, e rregullores së licencimit, parashikohet **paraqitja e vërtetimit për themeluesit se personi nuk është në ndjekje penale.**

Ky kriter është i rëndësishëm të përmbushet jo vetëm në periudhën e licencimit, por edhe gjatë të gjithë veprimtarisë së subjektit, pasi vetë rregullorja, në nenin 14 të saj parashikon se subjektit financiar i pezullohet apo i revokohet licenca, nëse nuk përmbush kushtet bazë për të cilat është licencuar dhe, siç e përmendëm edhe më sipër, një ndër kushtet kryesore është reputacioni i themeluesit (ortakut) të shoqërisë. Nëse ky reputacion cenohet, atëherë subjekti nuk mund të ushtrojë veprimtarinë financiare për të cilën është licencuar pasi bie një nga kriteret kryesore të licencimit, që ka të bëjë me reputacionin e tij për të ushtruar veprimtarinë për të cilat është licencuar.

Vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë për revokimin e licencës të subjektit “Final” sh.p.k. dhe fakti që hetimi ndaj ortakut të vetëm të shoqërisë lidhet me veprimtarinë e këtij subjekti, gjen mbështetje edhe nga ecuria e veprimeve procedurale të ndërmarra nga organi i akuzës. Me shkresën nr. 12828 prot., datë 29.5.2024, jemi informuar nga Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm të Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “*Pastrimin e produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale*” për vepra penale të dyshuara gjatë ushtrimit të aktivitetit financiar edhe të shoqërisë “Final” sh.p.k., si dhe ka urdhëruar bllokimin e llogarive bankare ndër të tjera edhe të kësaj shoqërie, ortakut të vetëm të saj Arben Meskuti dhe personat e lidhur me të.

Në analizë të arsyetimit të mësipërm, konstatoj se vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë për revokimin e licencës së këtij subjekti është e përshtatshme dhe gjendet plotësisht e mbështetur në aktet rregullative të cituara në këtë vendim.

Bazuar në sa më sipër, vlerësoj se pretendimet e paraqitura në ankimin administrativ nga “Final”

sh.p.k. nuk janë të bazuara dhe nuk përbëjnë shkak për të marrë një vendim të ndryshëm nga ai me nr. 2303, datë 23.5.2024.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 93, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 130–140 të Kodit të Procedurave Administrative,

VENDOSA:

1. Refuzimin e ankimit si të pabazuar dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 2303, datë 23.5.2024, të Guvernatorit, për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë “Final” sh.p.k.

2. Vendimi t’i njoftohet subjektit ankimues “Final” sh.p.k.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatë sipas ligjit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare.

GUVERNATOR
Gent Sejko

VENDIM Nr. 100, datë 27.5.2024

MBI MIRATIMIN E “METODOLOGJISË SË SHPËRNDARJES SË TË ARDHURAVE NGA KONGJESTIONI I ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHQIPËRISË DHE KOSOVËS”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nën pikës 3.5 të pikës 3 të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 3, pika 8, të “Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO), si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator



të Energjisë (ERE) nr. 40, datë 6.3.2020; neneve 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe “Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës”, të datës 21.10.2021, nënshkruar nga ERE, Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST) sh.a., dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) sh.a.; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.5.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 175/5 prot., datë 24.5.2024 të për gatitur nga drejtoritë teknike mbi miratimin e “Metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës dhe procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri–Kosovë”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me propozim të shoqërisë OST sh.a., mori vendimin nr. 2, datë 22.1.2024, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës”.

- Vendimi i sipërcituar është publikuar në faqen *web* të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare nr. 23, datë 7.2.2024, ndërsa drafti i metodologjisë së propozuar u publikua në zërin “Konsultime” në faqen *web* të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 175/1 prot., datë 8.2.2024, njoftoi shoqëritë OST sh.a., dhe Bursa Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) sh.a., lidhur me vendimin nr. 2, datë 22.1.2024 të Bordit të ERE-s.

- Më tej, përgjatë shqyrtimit të draftdokumentit të propozuar për miratim, ERE me shkresën nr. 175/3 prot., datë 12.3.2024, iu drejtua shoqërisë OST sh.a., mbi paqartësitë dhe saktësime të tjera që lidhen me dokumentin e propozuar.

- Në përgjigje të shkresës sipërcituar, shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 1603/1, datë 2.4.2024, protokolluar në ERE me nr. 175/4 prot., datë 3.4.2024, sqaroi si vijon:

- Në “Metodologjinë e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës”, në nenin 5 (Parimet për ndarjen) është përcaktuar se OST sh.a., dhe KOSTT sh.a., do të

marrin pjesën e tyre të të ardhurave neto kufitare, bazuar në një koeficient të ndarjes 50% me 50%.

- Dokumenti i metodologjisë është për gatitur bazuar në parimet e parashikuara në nenin 73 të Rregullores së Komisionit (EU) 215/1222 dhe nenin 19 të Rregullores së Komisionit (EU) 2019/943, në parashikimet e marrëveshjes kuadër mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës të nënshkruar në vitin 2021 midis OST-ve dhe Enteve Rregullatore të Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe duke mbajtur në konsideratë përcaktimet e Memorandumit të nënshkruar në vitin 2020 midis OST-ve të Shqipërisë dhe Kosovës për vlerësimin dhe alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit midis dy vendeve, ku përcaktohet, se: “Palët do të marrin në konsideratë përdorimin e të njëjtës ndërfaqe të interkoneksionit dhe totali i NTC-së do të ndahet ndërmjet tyre në mënyrë të barabartë (50%/50%), me përjashtim të procesit brenda ditës”.

- Lidhur me shtojcën 1, shoqëria OST sh.a., sqaron se në bazë të nenit 54 të ligjit nr. 43/2015, i ndryshuar, Operatori i Sistemit të Transmetimit ka në pronësi sistemin e transmetimit të energjisë elektrike, që përfshin ndër të tjera dhe linjat 400 kV, 220 kV dhe 110 kV. Pra, OST sh.a. është e vetmja pronare e linjave të interkoneksionit Kosova B–Tirana 2, 400 kV (Koman–kufi) dhe Prizren–Fierzë 220 kV (Fierzë–kufi). Po kështu, KOSTT sh.a. është Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, i cili, sipas ligjit për energjinë elektrike nr. 05/L-085, të miratuar në vitin 2016, menaxhon Sistemin e Transmetimit të Republikës së Kosovës, duke operuar me nivele të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110 kV. Pra, dhe KOSTT sh.a., është e vetmja pronare e linjave të interkoneksionit Kosova B–Tirana 2, 400 kV (Kosova B–kufi), Prizren–Fierzë 220 kV (Prizren–kufi).

- Nisur nga sa me lartë, me terminologjinë “Aksione të pronësisë”, të tabelës së shtojcës 1, do të kuptohet pikërisht që e drejta e përfitimit të të ardhurave nga kongjestioni i përket vetëm këtyre dy shoqërive si pronare të vetme të linjave në shtetin përkatës (për shkak të së drejtës së pronësisë apo administrimit dhënë nga aktet ligjore në fuqi) dhe në masën 100% të pjesës që i takon secilës sipas koeficientit të përcaktuar në nenin 5 të metodologjisë, të dakordësuar për t’u aplikuar. Për këtë arsye, nga ana e OST sh.a., propozohet që në



shtojcën 1, të shtohet paragrafi: “Aksionet e pronësisë” - kuptohet që OST-të janë pronarë të vetëm ose zotërojnë pronësinë e plotë mbi linjat pjesë e interkonektorëve të listuar në tabelë, në shtetin përkatës.

- Gjithashtu, në shtojcën 1 janë reflektuar rregullimet e kolonës “Koeficienti i aplikuar për ndarjen e të ardhurave” në tabelë.

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën e sipërcituar, gjithashtu, ka përcjellë draftin e rishikuar të “Metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës”, të dakordësuar midis OST sh.a., KOSTT sh.a., dhe NEMO-s së Shqipërisë dhe Kosovës”, si dhe ka bërë me dije se është informuar dhe KOSTT sh.a. për rregullimet në aktin përkatës. Në dokumentacionin e përcjellë me anë të shkresës sipërcituar, u vërejt se janë konsideruar të gjitha ndryshimet e sugjeruara, si dhe janë dhënë sqarimet e kërkuara nga ERE.

- Në mbështetje të sa parashikohet në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në “Rregulloren e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO)”, si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 40, datë 6.3.2020, Bordi i ERE-s, me vendim nr. 369, datë 26.12.2023, vendosi ndër të tjera: 1. Caktimin e NEMO (ALPEX sh.a.) në rolin e “Agjentit të Transferimit” (*Shipping Agent*), për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës; dhe 2. Agjenti i Transferimit, të ardhurat të cilat mbliidhen nga konxhestionet do t'i transferojë OST-ve respektive jo më vonë se dy javë pas datës së shlyerjes.

- Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 872, datë 27.12.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 519, datë 13.7.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, në pikën 2, germa “b” ka

përcaktuar ndër të tjera, se: “OST-ja të vendosë në dispozicion të tregut të organizuar një sasi minimum (50%) të kapaciteteve ndërkufitare të disponueshme, që i përket bashkimit respektiv të tregjeve.”

- Në rastin konkret bashkimi i tregut ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës do të realizohet me 2 (dy) *bidding zones* (zona ofertimi) dhe për të realizuar këtë bashkim do të alokohet një sasi minimale prej 50% e kapacitetit ndërkufitar të disponueshëm.

- Shoqëria ALPEX sh.a., filloi operimin në zonën e ofertimit të Shqipërisë në 12 prill 2023. Gjithashtu, në datën 1 shkurt 2024, ALPEX sh.a., filloi operimin në zonën e ofertimit të Kosovës. Në kushtet, kur ka filluar operimi i ALPEX sh.a., në të dy zonat e operimit, vlerësohet dhe miratimi i metodologjisë së propozuar për të ndarë të ardhurat nga konxhestionet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni i energjisë elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



**METODOLOGJIA E SHPËRNDARJES SË TË ARDHURAVE NGA KONGJESTIONI
NDËRMJET SHQIPËRISË DHE KOSOVËS**

**Duke pasur parasysh që:**

- (1) Ndërmjet ERE, ZRRE, OST dhe KOSTT është nënshkruar marrëveshja kornizë me datë 21.10.2021 “Mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës” (në tekstin e mëtejme referuar si **“Marrëveshja Kornizë”**).
- (2) Në bazë të nenit 6.2, dhe nenit 7.2 të Marrëveshjes Kornizë, termat, kushtet ose metodologjitë dhe marrëveshjet pasuese duhet të bazohen në parimet e përkufizuara në Rregulloren e Komisionit (BE) 2015/1222 të 24 Korrikut 2015, që vendos udhëzimet mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionit, të jenë në një linjë me iniciativat rajonale dhe praktikrat e tjera të aplikueshme në Shqipëri dhe Kosovë si dhe në pajtim me kërkesat e parashikuara në vetë Marrëveshjen Kornizë.
- (3) Në bazë të nenit 7.3 nën-paragrafi (f) të Marrëveshjes Kornizë, OST, KOSTT dhe NEMO e Shqipërisë dhe Kosovës do të hartojnë një propozim për një metodologji për ndarjen e të ardhurave nga kongjestioni. Metodologjia do të ndihmojë funksionimin dhe zhvillimin e efektshëm afatgjatë të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe duhet të jetë në përputhje me parimet e përgjithshme të menaxhimit të kongjestionëve të parashikuara në nenin 66 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të Shqipërisë dhe nenin 57 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L – 085 për Energjinë Elektrike të Kosovës.
- (4) Në bazë të neni 6.4 nënparagrafi (h) të Marrëveshjes Kornizë, Rregullatorët do të miratojnë, ndër të tjera, Metodologjinë e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestionet, të propozuar nga NEMO, OST dhe KOSTT.
- (5) Në bazë të nenit 6.5 të Marrëveshjes Kornizë, Rregullatorët do të marrin parasysh kërkesat e iniciativave rajonale në nivel të Komunitetit të Energjisë dhe do të konsultohen, bashkëpunojnë ngushtë dhe bashkërendohen me njëri-tjetrin me qëllim që ato të miratohen pak a shumë në të njëjtën kohe. Të dy Rregullatorët, nëse e konsiderojnë të nevojshme, mund të bien dakord të zhvillojnë dhe nënshkruajnë një marrëveshje specifike që kërkon organizimin e konsultimeve të përbashkëta publike dhe duke siguruar që të gjitha termat, kushtet dhe metodologjitë e parashikuara në Nenin 6.4 të miratohen me të njëjtën përmbajtje identike.
- (6) OST, KOSTT dhe NEMO e Shqipërisë dhe Kosovës përgatitën Metodologjinë për shpërndarjen e të ardhurave nga kongjestioni (në tekstin e mëtejme referuar si **“Metodologjia CID”**).
- (7) Kjo Metodologji CID merr në konsideratë dispozitat mbi parimet e përgjithshme të të ardhurave nga kongjestioni në nenin 16 (6) të Rregullores (KE) nr. 714/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 13 Korrik 2009 “Mbi kushtet për qasjen në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike (në tekstin e mëtejme referuar si **“Rregullorja (KE) nr. 714/2009”**).
- (8) Metodologjia CID është strukturuar në dy pjesë. Së pari, përcaktimi dhe mbledhja e të ardhurave të kongjestionit të krijuara nga alokimi implicit i kapaciteteve në bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri-Kosovë (në tekstin e mëtejme



referuar si “AL- KS DAC”). Së dyti, shpërndarjen e të ardhurave të kongjestionit të mësipërm, ndërmjet OST dhe KOSTT.

- (9) Kjo metodologji CID e propozuar nga OST-të dhe NEMO e Shqipërisë dhe Kosovës i paraqitet për miratim Rregullatorëve përkatës në përputhje me Nenin 6 të Marrëveshjes Kornizë.

Metodologjia e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës

Neni 1 Qëllimi dhe objekti

1. Metodologjia e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni CID ka për qëllim të rregullojë mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni për:
 - a) Zonat ofertuese të Shqipërisë dhe Kosovës dhe interkonektorët ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës ku mbledhen të ardhurat nga kongjestioni;
 - b) Të ardhurat nga kongjestioni që vijnë nga alokimi i kapaciteteve bazuar në qasjen e NTC së koordinuar; dhe
 - c) Të ardhurat nga kongjestioni që vijnë nga alokimi i kapaciteteve në harkun kohor të ditës në avancë.

Neni 2 Baza ligjore

Kjo metodologji është hartuar dhe miratohet në përputhje me:

1. Ligjin nr. 43/2015, datë. 30/04/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar;
2. Ligjin Nr. 05/L – 085 dt. 21/07/2016 për energjinë elektrike të Kosovës;
3. Memorandumin e mirëkuptimit të Ballkanit Perëndimor 6, të nënshkruar në Vjenë me 27 Prill 2016 mbi zhvillimin e tregut rajonal të energjisë elektrike dhe krijimin e kornizës për bashkëpunime të tjera të ardhshme të nënshkruar edhe nga Shqipëria dhe Kosova;
4. Marrëveshjen Kornizë me datë 21.10.2021 “Mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës”;
5. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar;
6. Vendimin e Bordit të ERE nr.134, datë 06/09/2017 “Mbi licensimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a. në aktivitetin e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”;



7. Vendimin e Bordit të ERE nr. 247, datë 29.09.2022 “Mbi licencimin e “Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX” SHA, në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike”;
8. Vendimin e Bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022 “Për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX, përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes);
9. Vendimin e ZRRE Nr.V_1332_2020, datë 10.12.2020 “Mbi miratimin në parim të kërkesës së KOSTT për transferimin e disa të drejtave dhe detyrimeve të KOSTT tek ALPEX për operimin e tregut të ditës në avancë dhe brenda ditës të energjisë elektrike për territorin e Republikës së Kosovës.”;
10. Vendimin e Bordit të ERE nr. 197, datë 26.11.2020 “Mbi Miratimin e rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për zyrën e koordinimit të ankandeve në Europën Juglindore (SEE CAO), për kufijtë Shqipëri - Greqi, Shqipëri - Mal i Zi dhe Shqipëri – Kosovë”;
11. Vendimin e Bordit të ERE nr.228, datë 17.07.2023 dhe Vendimin e ZRRE V_1748_2023, datë 17.07.2023 "Mbi përcaktimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX” sh.a., si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”.

Neni 3

Përkufizimet dhe interpretimi

1. Për qëllimin e metodologjisë CID, termat e përdorur në këtë dokument do të kenë kuptimin e përkufizimeve të përfshira në aktet ligjore dhe nënligjore rregullatore dhe marrëveshjet midis OST -ve dhe NEMO-s së Shqipërisë dhe Kosovës.
2. Gjithashtu, në këtë metodologji CID, me termin “Të ardhurat neto kufitare” do të kuptojmë të ardhurat e kongjestionit të alokuara për kufirin e zonës ofertuese siç përcaktohet në këtë metodologji.
3. Përveç kësaj, në këtë metodologji CID, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe:
 - a. kufiri i zonës së ofertimit mund të përbëhet nga një ose më shumë interkonektore për qëllime të shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestionit;
 - b. përveç nëse nuk specifikohet ndryshe, termat e përdorur zbatohen në kontekstin e bashkimi të tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri – Kosovë (AL-KS DAC);
 - c. njëjësi tregon shumësin dhe anasjelltas;
 - d. titujt janë futur vetëm për lehtësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj metodologjie CID; dhe
 - e. çdo referencë ndaj legjislacionit, rregulloreve, urdhrave, instrumenteve, kodeve



ose ndonjë akti tjetër do të përfshijë çdo ndryshim, shtesë të tyre të mëvonshme, ose akte të tjera që i zëvendësojnë ato, nëse këto ndryshime dhe shtesa, ose akte të mëvonshme, në përputhje me dispozitat e tyre kalimtare dhe përfundimtare, lejohen të zbatohen në këtë metodologji.

Neni 4

Procesi dhe llogaritja e të ardhurave nga kongjestioni

1. ALPEX do të mbledhë të ardhurat e kongjestionit që dalin nga AL -KS DAC dhe do të sigurojë që të ardhurat e mbledhura nga kongjestioni t'i transferohen OST-ve nëpërmjet SEECAO.
2. Platforma e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike SHA (ALPEX) – EMCS, për çdo ditë klerimi, llogarit të ardhurat nga kongjestioni, për secilën Njësi Kohore të Tregut (MTU) në Euro të rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhe e barabartë me:

Diferenca e çmimeve midis dy zonave ofertuese (çmimi i zonës ofertuese që importon minus çmimin e zonës ofertuese që eksporton) shumëzuar me sasinë në MWh të energjisë elektrike që rrjedh/dispeçohet midis këtyre dy zonave (Skedulet e Shkëmbyera), ku:

- Çmimet e tregut që përdoren janë çmimet e parrumbullakosura për zonat e ofertimit AL dhe KS që llogariten nga algoritmi i PCR dhe më pas rrumbullakosen me dy shifra pas presjes. Çmimet e reja të rrumbullakosura përdoren nga platforma elektronike e ALPEX-EMCS për llogaritjen e të ardhurave nga kongjestioni.
- Fluksi respektiv orar i energjisë jepet nga skedulet (shkëmbimet) ndërkufitare (të rrumbullakosura me dy shifra pas presje) midis zonave të ofertimit të Shqipëri - Kosovës.
- Humbjet në sistem nuk do të përfshihen në llogaritjen e të ardhurave nga kongjestioni.

Neni 5

Parimet për ndarjen

1. OST dhe KOSTT, do të marrin pjesën e tyre të të ardhurave neto kufitare bazuar në një koeficient të ndarjes 50% me 50%. Detajet si dhe arsyet themelore përcaktohen në Shtojcën 1 të kësaj metodologjie.

Neni 6

Publikimi i të dhënave

1. OST dhe KOSTT do të publikojnë informacionin e kërkuar për transparencën e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni.
2. Informacioni në përputhje me paragrafin 1 do të publikohet për çdo fragment njësie kohore tregu dhe së paku në baza mujore.



Neni 7 Publikimi dhe zbatimi i metodologjisë CID

1. OST dhe KOSTT do të publikojnë metodologjinë CID me hyrjen në fuqi të vendimit të Enteve përkatëse rregullatore që e miratojnë atë.
2. OST dhe KOSTT do të zbatojnë metodologjinë CID në datën e zbatimit të metodologjisë së llogaritjes së kapaciteteve dhe implementimit të tregut të përbashkët të energjisë elektrike AL- KS.

Neni 8 Gjuha

Gjuha e kësaj metodologjie CID do të jetë gjuha shqipe.



SHTOJCA 1

Në përputhje me nenin 4 të metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni, kjo Shtojcë përshkruan koeficientin specifik të bashkëndarjes të zbatuar për bashkëndarjen e të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet OST-ve në kufirin e zonës së ofertimit.

Zona e ofertimit	Interkonektori	OST/Palët e përfshira	OST/Palët e përfshira	Koeficienti i aplikuar për ndarjen e të ardhurave	Arsyeja
AL-KS	Kosova B – Tirana 2400 kV	OST, KOSTT	OST, KOSTT	OST: 50 % KOSTT: 50%	Aksionet e pronësisë*
AL-KS	Prizren – Fierzë 220 kV	OST, KOSTT	OST, KOSTT	OST: 50 % KOSTT: 50%	Aksionet e pronësisë*

* Me “Aksionet e pronësisë” kuptohet që OST-të janë pronarë të vetëm ose zotërojnë pronësinë e plotë mbi linjat pjesë e interkonektorëve të listuar në tabelë, në shtetin përkatës.

Formula për llogaritjen e të ardhurave nga kongjestioni:

Të ardhurat nga kongjestioni = (çmimi i zonës ofertuese të importit – çmimi i zonës ofertuese të eksportit)* sasinë në MWh të transferuar



VENDIM

Nr. 101, datë 27.5.2024

MBI MIRATIMIN E “PROCEDURAVE REZERVË PËR BASHKIMIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË DITËS NË AVANCË SHQIPËRI-KOSOVË”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19 germa “e” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nënpikës 3.5, të pikës 3 të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 3, pika 8, të “Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO), si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 40, datë 6.3.2020; “Rregullores së alokimit në hije të kapaciteteve (*Shadow Auction*), në kuadër të bashkimit të tregjeve Shqipëri-Kosovë”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 308, datë 30.10.2023; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe “Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe të Kosovës” të datës 21.10.2021, nënshkruar nga ERE, Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST) sh.a., dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) sh.a.; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.5.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 175/5 prot., datë 24.5.2024 të përgatitur nga drejtoritë teknike mbi miratimin e “metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës dhe procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri-Kosovë”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me propozim të shoqërisë OST sh.a., mori vendimin nr. 3, datë 22.1.2024, mbi fillimin e procedurës për miratimin e

“Procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri-Kosovë”.

- Vendimi sipërcituar është publikuar në faqen *web* të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare nr. 23, datë 7.2.2024, ndërsa drafti i propozuar i procedurave rezervë gjendet i publikuar në zërin “Konsultime” në faqen *web* të ERE-s.

- Në vijim, ERE, me shkresën nr. 175/2 prot., datë 8.2.2024, njoftoi shoqëritë OST sh.a. dhe Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) sh.a., mbi me vendimin nr. 3, datë 22.1.2024, të Bordit të ERE-s.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 308, datë 30.10.2023, vendosi miratimin e “Rregullores së alokimit në hije të kapaciteteve (*Shadow Auction*)”, në kuadër të bashkimit të tregjeve Shqipëri-Kosovë, e cila aplikohet si procedurë rezervë nga SEE CAO.

- Në këto kushte, sikurse përcaktohet në nenin 6 të draftprocedurave rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë Shqipëri-Kosovë: “Në rast se procesi i bashkimit të tregut të ditës në avancë nuk është në gjendje të prodhojë rezultate, OST-ja dhe KOSTT-ja do të iniciojnë procedurën rezervë të ditës në avancë dhe do të nisin ekzekutimin e ankandeve në hije në platformën e alokimit të SEE CAO.”.

- Miratimi i “Procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri-Kosovë”, të propozuara nga OST sh.a., vlerësohet se plotëson kuadrin rregullator për operimin e tregut të ditës në avancë dhe në rastet kur procesi i bashkimit të tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri-Kosovë nuk është në gjendje të prodhojë rezultate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri-Kosovë” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga



data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti



**PROCEDURAT REZERVË PËR BASHKIMIN E TREGUT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË DITËS NË AVANCË
SHQIPËRI – KOSOVË**

**Duke pasur parasysh që:**

1. Ndërmjet ERE, ZRRE, OST dhe KOSTT është nënshkruar marrëveshja kornizë me datë 21.10.2021 “Mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës” (në tekstin e mëtejme referuar si **“Marrëveshja Kornizë”**).
2. Në bazë të nenit 6.2, dhe nenit 7.2 të Marrëveshjes Kornizë, termat, kushtet ose metodologjitë dhe marrëveshjet pasuese duhet të bazohen në parimet e përkufizuara në Rregulloren e Komisionit (BE) 2015/1222, të 24 Korrikut 2015, që vendos udhëzimet mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionit, të jenë në një linjë me iniciativat rajonale dhe praktikatat e tjera të aplikueshme në Shqipëri dhe Kosovë si dhe në pajtim me kërkesat e parashikuara në vetë Marrëveshjen Kornizë.
3. Në bazë të nenit 7.3 nën-paragrafi (f) të Marrëveshjes Kornizë, OST, KOSTT dhe NEMO e Shqipërisë dhe Kosovës do të hartojnë një propozim për procedura rezervë për të siguruar alokim efikas, transparent dhe jodiskriminues të kapaciteteve nëse procesi i bashkimit të tregut të ditës në avancë nuk është në gjendje të prodhojë rezultate.
4. Në bazë të neni 6.4 nën paragrafi (h) të Marrëveshjes Kornizë, Rregullatorët do të miratojnë, ndër të tjera, procedurat rezervë, të propozuara nga OST dhe KOSTT.
5. Në bazë të nenit 6.5 të Marrëveshjes Kornizë, Rregullatorët do të marrin parasysh kërkesat e iniciativave rajonale në nivel të Komunitetit të Energjisë dhe do të konsultohen, bashkëpunojnë ngushtë dhe bashkërendohen me njëri-tjetrin me qëllim që ato të miratohen pak a shumë në të njëjtën kohe. Të dy Rregullatorët, nëse e konsiderojnë të nevojshme, mund të bien dakord të zhvillojnë dhe nënshkruajnë një marrëveshje specifike që kërkon organizimin e konsultimeve të përbashkëta publike dhe duke siguruar që të gjitha termat, kushtet dhe metodologjitë e parashikuara në Nenin 6.4 të miratohen me të njëjtën përmbajtje identike.
6. Këto procedura rezervë janë një propozim i përbashkët i zhvilluar nga OST dhe KOSTT si Operatorë të Sistemit të Transmetimit, të cilët synojnë të sigurojnë alokim efikas, transparent dhe jodiskriminues të kapaciteteve, në rast se procesi i bashkimit të tregut të ditës në avancë Shqipëri – Kosovë nuk është në gjendje që të prodhojë rezultate.
7. Procedurat rezervë mbajnë në konsideratë dispozitat mbi parimet e përgjithshme të pasqyruara në Rregulloren e Komisionit (BE) 2015/1222 të 24 Korrikut 2015, për krijimin e një udhëzuesi për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionit (**“Rregullorja CACM”**).
8. Procedurat rezervë do të zbatohen në rast se procesi i bashkimit të tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri – Kosovë nuk është në gjendje të prodhojë rezultate dhe merr parasysh zgjidhjet ekzistuese për të siguruar efikasitetin e kostos së zbatimit të procedurave rezervë, duke qenë se ato zgjidhje janë të harmonizuara për kufirin Shqipëri-Kosovë (AL-KS). Procedurat rezervë në kufirin Shqipëri-Kosovë (AL-KS) kontribuojnë dhe nuk pengojnë në asnjë mënyrë arritjen e objektivave për vazhdueshmërinë e operimit të tregut të organizuar të ditës në avancë dhe sigurojnë një qasje transparente dhe jodiskriminuese drejt lehtësimit të alokimit të kapaciteteve ndërzonale në rast se procesi i bashkimit të tregut të një dite më parë nuk është në gjendje të prodhojë rezultate.



9. Afati kohor i propozuar për zbatimin e këtyre procedurave rezervë do të përfshihet dhe mund të gjendet në Rregullat e Alokimit të Kapaciteteve nëpërmjet procedurës së ankandeve në hije, në kuadër të bashkimit respektiv të tregjeve Shqipëri-Kosovë.
10. Këto procedura rezervë për bashkimin e tregut të ditës në avancë Shqipëri – Kosovë të propozuara nga OST-të përkatëse siç kërkohet nga Neni 7.3 (c) i Marrëveshjes Kornizë, i paraqiten për miratim Rregullatorëve përkatës, në përputhje me nenin 6 të Marrëveshjes Kornizë.

Procedurat rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri – Kosovë

Neni 1 Objekti dhe fushëveprimi

1. Procedurat rezervë, siç përcaktohen këtu, do të konsiderohen si propozim i përbashkët i OST-ve AL-KS për të siguruar alokim efikas, transparent dhe jodiskriminues të kapaciteteve në rast se procesi i bashkimit të tregut të ditës në avancë, nuk është në gjendje plotësisht ose pjesërisht të prodhojë rezultate, në përputhje me aktet ligjore, nënligjore, rregullatore dhe marrëveshjet midis OST-ve dhe NEMO-s të Shqipërisë dhe Kosovës.
2. Fushëveprimi i procedurave rezervë nuk trajton caktimin e rolit dhe përgjegjësi të palëve specifike, e as nuk përpiqet të sigurojë një kornizë të qeverisjes për role ose përgjegjësi specifike. Këto aspekte do të përcaktohen nga OST-të AL-KS në përputhje me aktet ligjore, nënligjore, rregullatore dhe marrëveshjet midis OST-ve dhe NEMO-s të Shqipërisë dhe Kosovës.

Neni 2 Përkufizimet dhe interpretimi

1. Për qëllimet e këtyre procedurave rezervë, termat e përdorur do të kenë kuptimin e përkufizimeve të parashikuara në aktet ligjore, nënligjore, rregullatore dhe marrëveshjet midis OST-ve dhe NEMO-s të Shqipërisë dhe Kosovës. Për më tepër, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
 - a. ‘Ankandi në hije (Shadow auction)’ do të thotë ankand eksplisit i organizuar përmes Platformës së alokimit me anë të cilit kapaciteti ditor ndërzonal ofrohet si procedurë rezervë e procesit të bashkimit të tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri – Kosovë dhe u alokohet pjesëmarrësve të tregut që dorëzojnë ofertë(at) sipas Rregullave të ankandit në hije;
 - b. ‘Platforma e alokimit’ do të thotë entiteti i emëruar dhe i autorizuar nga OST-të AL-KS për të vepruar në emër të tyre dhe në emër të tij për alokimin e kapacitetit ndërzonal nëpërmjet ankandeve në hije;
 - c. ‘Rregullat e alokimit në hije’ do të thotë rregullat për ankandet në hije të zbatuara nga



platformat e alokimit dhe të publikuara në faqen e internetit të platformës së alokimit¹, gjithmonë në versionin e tyre të fundit;

- d. ‘NEMO i AL-KS’ nënkupton NEMO-të e përcaktuara zyrtarisht në Kosovë dhe Shqipëri në përputhje me Rregulloren ose Vendimin përkatës të miratuar nga ERE dhe ZRRE për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), konkretisht Vendimin e Bordit të ERE nr. 40, datë 06.03.2020 të “Për Miratimin e Rregullores së Kërkesave dhe Procedurave për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), si dhe Rolet dhe Përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar” dhe Rregullës nr. 04 të Shtatorit 2020 të ZRRE-së për “Përcaktimin e Operatorit të Nominuar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për Kryerjen e Aktiviteteve që kanë të bëjnë me bashkimin e tregut dhe funksionimin e përbashkët të tregut”;

‘Ndarja e plotë e bashkimit të tregjeve’ nënkupton situatën kur bashkimi i tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri – Kosovë, nuk ka mundur të prodhojë rezultate duke ndikuar në të dy zonat ofertuese brenda tij, duke çuar në zbatimin e procedurave rezervë në çdo kufi të zonës ofertuese.

Neni 3 Baza ligjore

Këto procedura rezervë janë hartuar dhe miratohen në përputhje me:

1. Ligjin nr. 43/2015, dt. 30/04/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar;
2. Ligjin nr. 05/L - 085 dt. 21/07/2016, për energjinë elektrike të Kosovës;
3. Memorandumin e mirëkuptimit të Ballkanit Perëndimor 6, të nënshkruar në Vjenë më 27 Prill 2016, mbi zhvillimin e tregut rajonal të energjisë elektrike dhe krijimin e kornizës për bashkëpunime të tjera të ardhshme të nënshkruar edhe nga Shqipëria dhe Kosova;
4. Marrëveshjen Kornizë me datë 21.10.2021, “Mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës”;
5. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 519 datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike, i ndryshuar;
6. Vendimin e Bordit të ERE nr. 134, dt. 06/09/2017, “Mbi licensimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a. në aktivitetin e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”;
7. Vendimin e Bordit të ERE nr. 247, datë 29.09.2022, “Mbi licensimin e “Bursës Shqiptare

¹ <https://www.seecao.com/>



të Energjisë Elektrike – ALPEX” SHA, në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike”;

8. Vendimin e Bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022, “Për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX, përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes);
9. Vendimin e ZRRE Nr.V_1332_2020, datë 10.12.2020, “Mbi miratimin në parim të kërkesës së KOSTT për transferimin e disa të drejtave dhe detyrimeve të KOSTT tek ALPEX për operimin e tregut të ditës në avancë dhe brenda ditës të energjisë elektrike për territorin e Republikës së Kosovës.”;
10. Vendimin e Bordit të ERE nr.228, datë 17.07.2023 dhe Vendimin e ZRRE V_1748_2023, datë 17.07.2023 "Mbi përcaktimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX” sh.a., si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”.

Neni 4 Informimi nga NEMO

1. NEMO e Shqipërisë dhe Kosovës që kryen funksionin e Operatorit të Bashkimit të Tregut (MCO) do të informojë OST-të e Shqipërisë dhe Kosovës dhe SEECAO, në rast të ndarjes së plotë të bashkimit të tregut që ndikon në interkoneksionin Shqipëri-Kosovë (AL-KS); në përputhje me aktet ligjore, nënligjore, rregullatore dhe marrëveshjet midis OST-ve dhe NEMO-s të Shqipërisë dhe Kosovës.

Neni 5 Kërkesa për një sistem të përbashkët komunikimi rezerve

1. Në një sesion normal të bashkimit të tregut, OST dhe KOSTT do të krijojnë komunikim ndërmjet njëri-tjetrit nëpërmjet një mekanizmi kryesor (platformat elektronike përkatëse) të shkëmbimit të të dhënave.
2. OST dhe KOSTT duhet të krijojnë të paktën një lidhje alternative ndërmjet tyre përmes mekanizmit rezervë të shkëmbimit të të dhënave. Nëse shfaqet një problem me mekanizmin kryesor të shkëmbimit të të dhënave, shpërndarja e të dhënave do të bëhet me mekanizmin rezervë të shkëmbimit të të dhënave.
3. Mekanizma të ndryshëm alternativë (e-maili/ telefoni) për shkëmbimin e të dhënave hyrëse dhe dalëse ndërmjet OST dhe KOSTT, do të krijohen duke marrë parasysh zgjidhjet teknike të disponueshme.
4. Në zbatim të pikës 1, 2 dhe 3 të këtij neni, OST dhe KOSTT do të veprojnë si më poshtë në lidhje me përcaktimin dhe komunikimin e informacionit të kapacitetit ndërkufitar që do vihet në dispozicion të bashkimit të tregjeve:
 - i. Kur njëra nga OST-të nuk e ka funksionale platformën elektronike, do t'i komunikojë me email, menjëherë OST-së tjetër se nuk ka mundësi ta gjenerojë/dërgojë informacionin e saj të kapacitetit ndërkufitar. Informacioni i kapacitetit ndërkufitar do të vihet në dispozicion



të bashkimit të tregjeve, në mënyrë automatike nëpërmjet platformës elektronike nga OST-ja me platformën elektronike funksionale tek NEMO dhe do të përfshijë dhe konfirmimin e OST-së, që nuk e ka platformën elektronike funksionale.

- ii. Kur të dyja OST-të nuk e kanë komunikimin me platformë elektronike si mekanizëm kryesor, ky komunikim do të bëhet me e-mail për t'i komunikuar NEMO-s informacionin e kapacitetit ndërkufitar në dispozicion të bashkimit të tregjeve.
 - iii. Kur përveç mungesës së komunikimit me platformë elektronike ndodh edhe që njëra nga OST-të nuk e ka funksionale komunikimin elektronik me e-mail, do t'i komunikojë me me telefon, menjëherë, informacionin e saj të kapacitetit ndërkufitar OST-së tjetër (me komunikim funksional elektronik me e-mail). Informacioni i kapacitetit ndërkufitar do të vihet në dispozicion të bashkimit të tregjeve me e-mail nga OST-ja me komunikim funksional elektronik me e-mail tek NEMO dhe do të përfshijë dhe konfirmimin e OST-së që nuk e ka komunikimin elektronik me e-mail funksionale.
5. Të dhënat konfidenciale do të shkëmbehen gjithmonë në mënyrë të sigurtë.

Neni 6 Procedura rezervë

1. Në rast se procesi i bashkimit të tregut të ditës në avancë nuk është në gjendje të prodhojë rezultate, OST dhe KOSTT do të iniciojnë procedurën rezervë të ditës në avancë dhe do të nisin ekzekutimin e ankandëve në hije në platformën e alokimit të SEECAO.
2. Ankandet në hije mbahen shtatë ditë në javë, duke përfshirë fundjavën dhe festat publike, në përputhje me rregullat e ankandit në hije.
3. Specifikimi i ankandit të një ankandi në hije do të publikohet nga platforma e alokimit të SEECAO, paraprakisht sipas Rregullave të ankandit në hije.

Neni 7 Pamundësia për fillimin e procedurave rezervë (Ankandit në hije)

Në rast të pamundësisë për fillimin apo zhvillimin e procedurave të ankandit në hije, do të zbatohen parashikimet e Rregullave të ankandit në hije të SEECAO.

Neni 8 Data e zbatimit

Këto procedura do të zbatohen pas miratimit nga Entet Rregullatore të Shqipërisë dhe Kosovës.

Neni 9 Gjuha

Gjuha e këtyre Procedurave do të jetë gjuha shqipe.



VENDIM

Nr. 107, datë 31.5.2024

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 175, DATË
4.11.2020, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘TIRANA ENERGJI’ SHPK,
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
‘MALI’, ME KAPACITET TË INSTALUAR
1490 kw”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 933/4 prot., datë 29.5.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 175, datë 4.11.2020, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Tirana Energji’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Mali’ me kapacitet të instaluar 1490 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 175, datë 4.11.2020, vendosi të licencojë shoqërinë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Mali”, me kapacitet të instaluar 1490 kw, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që të depozitojë në ERE kontratën e qirasë “Për dhënie në përdorim të sipërfaqes së zonës së mbrojtur”, të lidhur mes shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k. dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Tiranë, brenda datës 7.1.2024.

- Në lidhje me kushtin e sipër cituar, ERE, me shkresën nr. 2406 prot., datë 14.11.2023, ka kujtuar shoqërinë për depozitimin e kontratës së qirasë brenda afateve të përcaktuara në vendim, apo çdo dokumentacion tjetër që rregullon pronësinë.

- Në vijim, ndërmjet ERE-s dhe shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k. është zhvilluar një korrespondencë me shkresat (nr. 933 prot., datë 15.4.2024; nr. 933/1 prot., datë 22.4.2024; nr. 933/2 prot., datë 20.5.2024), dhe së fundmi me shkresën

nr. 933/3 prot., datë 23.5.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e plotë, kontratën “Për dhënie në përdorim të territoreve në zonat e mbrojtura mjedisore” me nr. 55/3 prot., datë 1.2.2024, të lidhur ndërmjet shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k. dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Tiranë. Në nenin 2 të kësaj kontrate është cituar se kjo kontratë lidhet për një afat 5-(pesë)-vjeçar, afati i kësaj kontrate fillon nga dita kur qiramarrësit i dorëzohet territori me procesverbal, procesverbali është mbajtur në datën 15.2.2024, ndërmjet përfaqësuesve të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Tiranë dhe përfaqësuesit të subjektit “Tirana Energji” sh.p.k. Si e tillë, në kuptim të nenit 2 të kontratës, i cili lidhet me përllogaritjen e afateve dhe vlefshmërinë e kontratës, konstatohet se kontrata e qirasë mes ADZM Tiranë dhe shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k. ka hyrë në fuqi në datën 15.2.2024, me afat vlefshmërie deri më 15.2.2029.

- Me depozitimin e këtij dokumentacioni shoqëria ka plotësuar kushtin e lënë në pikën 2, të vendimit nr. 175/2020, por kjo kontratë nuk mbulon të gjithë afatin e vlefshmërisë së licencës së shoqërisë, si e tillë vlerësohet që në dispozitivin e vendimit të ndryshojë përcaktimi i pikës 2, ku të përcaktohet se shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar me ADZM Tiranë “Për dhënie në përdorim të territoreve në zonat e mbrojtura mjedisore”, brenda datës 15.2.2029, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti.

- Një tjetër leje që ka afat për t’u depozituar në vijim është dhe leja e përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor nga HEC “Mali”, si e tillë, vlerësohet që në dispozitivin e vendimit të ndryshojë përcaktimi i pikës 3, me përmbajtjen: “Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Mali”, brenda datës 23.9.2024.

- Po ashtu, të ndryshojë dhe përcaktimi i pikës 4 me përmbajtjen: “Në rast se shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k. nuk depoziton në afat lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor, sikurse përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, dhe ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrtojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.



- Pas pikës 4, vlerësohet të shtohet pika 5 në dispozitivin e vendimit, me përmbajtjen: “Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të tij.”.

- Pas pikës 5, të shtohet pika 6 në dispozitivin e vendimit, me përmbajtjen: “Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Tirana Energji” sh.p.k., Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL sh.a.), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

- Në nenin 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, apo ndryshimin e tij, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 175, datë 4.11.2020, ndryshon dhe bëhet:

“2. Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE informacion mbi rinovimin e kontratës së qirasë me ADZM Tiranë 3 (tre) muaj para nga afati i vlefshmërisë, dhe ta depozitojë atë brenda datës 15.2.2029 ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti.”.

2. Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 175, datë 4.11.2020, ndryshon dhe bëhet:

“3. Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Mali”, brenda datës 23.9.2024.”.

3. Pika 4, e vendimit të Bordit të ERE-s nr.175, datë 4.11.2020, ndryshon dhe bëhet:

“4. Në rast se shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k. nuk depoziton në afat lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor, sikurse përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, dhe ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrtojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.”.

4. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me përmbajtjen si më poshtë:

“5. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të tij.”.

5. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me përmbajtjen si më poshtë:

“6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Tirana Energji” sh.p.k., Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Furnizuesin e Tregut të Lirë, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

SHKURTIM VENDIMI Nr. 8762, datë 4.3.2024

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e përbërë nga:

Antonela Prendi, gjyqtare,

asistuar nga sekretare gjyqësore Aurora Cahani, sot, më datë 4.3.2024, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen civile me nr. 8762 akti, që i përket:

KËRKUES: Shoqëria “Besa Agro Invest” sh.p.k., regjistruar më datë 26.5.2014, me qendër në Fushë-Krujë, Arrameras, nr. pasurie 328/75, vol. 14, f. 209, ZK 1042, NIPT L41726002A, përfaqësuar nga administratori Estref Cekrezi dhe avokati Taulant Naco.

OBJEKTI: Kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë tregtare “Besa Agro Invest” sh.p.k., me kërkesë të debitorit. Caktimin e administratorit të falimentimit. Vendosijen e masës së sigurimit mbi të gjitha pasuritë e luajtshme, të paluajtshme, si dhe të drejtat e debitorit.



BAZA LIGJORE: Nenet 7, 13, 14, 15, 17 të ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016, “Për falimentimin”. Nenet 41, 42, 153, 334 të KPrC-së.

Gjykata, pasi administroi provat, deklaroi të mbyllur hetimin gjyqësor, dëgjoi konkluzionet përfundimtare të palës kërkuese, e cila kërkoj pranimin e kërkesës dhe si çmoi provat në tërësi,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Hapjen më datë 4.3.2024, ora 15:00, të procedurave të falimentimit për shoqërinë “Besa Agro Invest” sh.p.k., NIPT L41726002A, reregjistruar më datë 26.5.2014, me qendër të ushtrimit të aktivitetit në Durrës, Fushë-Krujë, Arrameras, Rruga e Celeve, Fushë-Krujë, Arrameras, me ortak Fondacionin “Albanian Besa Capital”, me administrator z. Estref Cekrezi, dhe objekt veprimtarie: “Kultivimi i kulturave të ndryshme bujqësore dhe tregtimin e tyre me shumicë dhe me pakicë. Kultivimi i ullirit, vreshtave dhe pemëve frutore, me qëllim tregtimin e produkteve dhe nënprodukteve të tyre me shumicë dhe me pakicë. Prodhimin e farërave dhe të fidanëve dhe tregtimin e tyre. Ngritjen e industrisë përpunuese të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Ngritjen dhe zhvillimin e agroturizmit. Eksperimentimin e teknologjive të reja në kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore. Import-eksport dhe tregti me shumicë dhe me pakicë të të gjitha prodhimeve bujqësore blegtorale të përpunuara (industrializuara), e të freskëta të gjalla, blerjes së farave, fidanëve, medikamenteve të ndryshme për mbrojtjen nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Import-eksport dhe tregti me shumicë dhe me pakicë të makinerive për prodhim bujqësor dhe blegtoral, traktorë, mjete transporti, si dhe linja dhe makineri të përpunimit të produkteve agroushqimore etj. Nxitjen dhe organizimin e të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me prodhimin dhe tregtimin e prodhimeve të fermerëve. Konsulencë në fushën e ekonomisë, bujqësisë, blegtorisë dhe ushqimit, duke përfshirë planet e menaxhimit të cilësisë, mjedisit, turizmit dhe agroturizmit.

3. Caktimin si administratore e falimentimit të znj. Shpresë Breçani, atësia Dem, amësia Hajrie, datëlindja 20.3.1964, lindur në Tropojë, banuese në Tiranë, adresa rruga “Panorama” pallati Sara-El, me nr. licence 09 dhe ID G45320378H.

3. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. duhet të paraqesin pretendimet e tyre pranë administratores së falimentimit znj. Shpresa Breçani, brenda 45 ditëve nga publikimi i vendimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. duhet të njoftojnë administratoren e falimentimit Shpresa Breçani për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasurinë e debitorit.

5. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit shoqëria “Besa Agro Invest” sh.p.k. duhet t’i paguajnë dhe shlyejnë ato pranë administratores së falimentimit Shpresa Breçani.

6. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. për raportim të mbahet brenda 60 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

7. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve të tyre.

8. Urdhërohet publikimi i shkurtimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.

9. Një kopje e këtij vendimi t’i komunikohet administratores së falimentimit Shpresa Breçani.

10. Një kopje e këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. t’i komunikohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim njoftimin të gjitha drejtorive rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

11. Një kopje e këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. t’u komunikohet të gjithë bankave të nivelit të dytë në RSH.

12. Një kopje e këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. t’i komunikohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

13. Një kopje e këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. t’i komunikohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

14. Një kopje e këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. t’i komunikohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

15. Një kopje e këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Besa Agro



Invest” sh.p.k. t’i komunikohet Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

16. Një kopje e këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. t’i komunikohet Dhomës Kombëtare të Noterëve.

17. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuarit.

18. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

U shpall në Tiranë, më datë 4.3.2024

GJYQTARE
Antonela Prendi

Shënim. Vendimi mori formë të prerë, pasi nuk u ankimua më datë 30.5.2024.

Tiranë, më datë 3.6.2024.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 289 (1861), datë 16.4.2024, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasës Sose Gilaj, e datëlindjes 30.1.1967, lindur në Curraj Eper, Tropojë dhe banuese në Shkodër me atësinë Nikë dhe amësinë Shkurte, si dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë ligjore të kërkuarit, shtetasit Florjan Zef Gilaj.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 152 (970), datë 27.2.2024, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Gjon Kuqaj, i datëlindjes 18.1.1964, lindur dhe banues në Hajmel, Shkodër me atësinë Nikollë dhe amësinë Çile, si dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të kërkuarit, shtetasit Zef Kuqaj.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë

